

Burimet: H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; I. Koci, *Genocidi...*, 503; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Fetah (Hasan) Krasniqi

(1.06.1972, shqiptar nga Gjurgjeviku i Vogel/ Mali Đurđevik, komuna e Klinës/Klina, pjesëtar i UÇK-së)

Fetahu jetonte në Belgjikë, përpara se të shpërthente lufta në Kosovë. Në fillim të muajit maj të vitit 1998, nga Belgjika ka kaluar në Shqipëri, në qytetin e Tropojës. Në UÇK u inkuadrua në datën 10.05.1998. E caktuan në shtabin e UÇK-së në Smolicë/Smonica dhe ishte nën komandën e Ismet Ahmetit. U plagos në luftimet me forcat serbe në **Dobrosh/Dobroš** më **27.07.1998**. Pas pak, ndërroi jetë nga plagët vdekjeprurëse. Pjesëtarë të UÇK-së e kanë varrosur në varrezat lokale. Pas mbarimit të luftës, mbetjet e tij mortore u rivarrosën me nderime ushtarake në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Smolicë/Smonica.

Burimet: H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Dragan (Dimitrije) Dušanić

(15.01.1951, serb nga Prishtina/Priština, pesë fëmijë, pjesëtar i UJ-së)

Goran (Velimir) Ostojić

(20.01.1962, malazez nga Nishi, një fëmijë, pjesëtar i UJ-së)

Srđan (Živko) Stancetić

(16.04.1974, serb nga Nishi, pjesëtar i UJ-së)

Radoš (Dragoje) Cerović

(22.10.1978, serb nga Leskoci, student, pjesëtar i UJ-së)

Gorani ka qenë kryeshefi i shtabit të Brigadës së 63 Parashutiste të UJ-së. Ka marr pjesë në të gjitha luftërat e ish Jugosllavisë, duke filluar nga Sllovenia. Radoši ka qenë futbollist. Në muajin shtator të vitit 1997, ka shkuar në shërbimin e rregullt ushtarak në UJ. Shkoi vullnetarisht. Shërbente si pjesëtar i Brigadës së 63 Parashutiste të UJ-së. Dragani ka qenë pjesëtar aktiv i UJ-së për afro 20 vjet dhe pjesëtar i Brigadës së 63 Parashutiste të UJ-së vetëm për disa vjet. Srđani, pas mbarimit të shkollës

së mesme ushtarake, u caktua në krye të shërbimit të lidhjeve të Brigadës së 63 Parashutiste të UJ-së.

Në mbrëmjen e datës **28.07.1998**, një autokolonë e UJ-së, në të cilën gjendeshin Gorani, Dragani, Radoši dhe Srđani, lëvizte nga Juniku/Junik drejt postbllokut ushtarak të **Koshares/Košare**. Ranë në pritë të UÇK-së. I pari u vra Gorani, e më pas Dragani, Srđani dhe Radoši. Trupin e Srđanit e kanë gjetur pjesëtarët e UJ-së më 31.07.1998, gjatë kontrollit të terrenit. Ai u varros më 03.08.1998 në varrezat lokale në Banovo Polje [Bogatiq]. Familjarët e Radošit i kanë marrë mbetjet e tij mortore më 30.07.1998 dhe, në të njëjtën ditë, me nderime ushtarake është kryer varrimi i tyre në varrezat e quajtura Svetoiljsko groblje në Leskoc. Familja e Draganit e ka marr trupin e tij më 30.07.1998. Në të njëjtën ditë, varrimi i tij është bërë me nderime ushtarake në varrezat në afërsi të kazermës ushtarake në Prishtinë/Priština.

Burimet: deklarata D.C, FDH-15752; deklarata D.V, FDH-15393; deklarata Ž.S, FDH-28268; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), IT-02-54, D300.91, FDH-30602; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 24, 49, 65, 73; KKMRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817.

Dragan (Branislav) Ristić

(19.02.1970, serb nga Knjazhevci, lëkurëtar, dy fëmijë, pjesëtar i UJ-së)

Deri në muajin prill të vitit 1996, Dragani punonte në Fabrikën e Këpucëve *Leda*, e më pas, për shkak të situatës së rëndë materiale, ai u punësua në ushtri si vozitës. Me bashkëshorten Zlaten, djemtë Željkon dhe Nikolën, prindërit Branislavin dhe Jorden, gjyshen dhe gjyshin jetonte në shtëpinë familjare në Rrugën *Đura Jakšić* numër 26, në Knjazhevc. Përpara shkuarjes në Kosovë, Dragani e ka kryer trajnimin në fshatin Bllato te Piroti/Pirot. Në Prishtinë/Priština ka arritur më 29.07.1998. Një ditë më pas, më **30.07.1998**, njësi i Draganit u dërgua në kufirin me Shqipëri. Dragani e ngjiste kamionin në kuadrin e autokolonës. Përderisa kalonte nëpër **Smolicë/Smonica**, autokolona ka rënë në pritë të forcave të UÇK-së. Dragani u qëllua me një